



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 20. 12. 2019, pas shqyrtimit të propozim Rregullores të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

#### VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK GADIME E ULËT DHE BABUSH I MUHAXHERËVE

#### Neni 1

#### Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim, zëvendësohen dy anëtarët e Komisionit vlerësues të caktuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.463-48449 të datës 19.07.2019 për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr 463-14811 i datës 04.03.2019, ashtu që Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim me numër rendor 1, kryesues i komisionit nga ekzekutivi i Komunës zëvendësohet nga Bekim Shabani, Drejtor, nga ekzekutivi i Komunës ndërsa anëtari në numrin rendor 2 Ilir Tasholli, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime publike zëvendësohet nga , Nazim Gashi, Drejtor nga ekzekutivi i komunës,

#### Neni 2

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë

Anëtarët e sapozgjedhur kanë detyrë dhe përgjegjësi të vazhdojnë zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr 463-48449 të datës 19.07.2019 konform dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr.15- 020-79227

Lipjan, më 20. 12. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit  
**Daut Azemi**